



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**VENDIM**

Nr. 2, Datë 24.09.2014

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E  
HIDROCENTRALEVE “DUNICA 1”, “DUNICA 2”, “TREBINJË”, “POTGOZHAN”  
DHE “KALIVAC”, NË PELLGUN E DUNICËS, KOMUNA TREBINJË, QARKU  
KORÇË**

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e hidrocentraleve “Dunica 1”, “Dunica 2”, “Trebinjë”, “Potgozhan” dhe “Kalivaç”, për shoqërinë koncensionare Hec-i Dunicë Sh.p.k.
2. Bashkëlidhet materiali i plotë grafik, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**



**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**



**Z. DAMIAN GJIKNURI**



**MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**